

STATUT I SHOQERISE
“TERRA INVEST SOLUTIONS” Sh.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 03/04/ 2024, personat e mëposhtem:

1. **Z.Eduart Alicanaj**, shtetas Shqiptar, atesia Zenel, lindur në Fier më 04/10/1985 dhe banues ne Tirane, , mbajtës i dokumentit karte identiteti me Nr.034638331 dhe Nr Personal I51004056B, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Z.Olgen Cikopana**, shtetas Shqiptar, atesia Aleksander, lindur në Korçe më 25/04/1989 dhe banues ne Tirane, , mbajtës i dokumentit karte identiteti me Nr.036061342 dhe Nr.Personal I90425097U, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republikën e Shqiperise, kane miratuar kete Statut si vijon:

KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1
Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte “**TERRA INVEST SOLUTIONS**” **Sh.P.K.**
Shoqeria “**TERRA INVEST SOLUTIONS**” **Sh.P.K.** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas refeuar si “**Ligji Tregtar**”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).
Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Regjistrimit (me pas refeuar si “**QKR**”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.
Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.
Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 2
Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: Rruga “Komuna e Parisit”, Nd 1, Shk 1, Ap 28 Tirane.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Objekti



Objekti veprimtarisë Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:

Konsulence juridike dhe financiare, shërbime dhe zbatime në fushën e ndërtimit, menaxhim dhe ndërmjetësim në dhenie me qera dhe shitje-blerje pronash, shërbime dhe zbatime në fushën e burimeve të energjisë së rinovueshme, projektim dhe instalim karikues për makina elektrike, logjistike, import-eksport, shërbime pastrimi, konsulencë teknike, planifikim i kualifikuar i projekteve, ndërmjetësim, supervizim, auditim, trajnim, shitje-blerje interneti me shumicë e pakice, internet service provider (isp) si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria mund të priset në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10,000 Leke (dhjetë mijë). Kapitali themeltar përbehet nga (dy) kuota që janë paguar e zotërohen teresisht nga ortakët themelues si vijon:

- Ortaku Eduart Alicanaj zotëron 1 (një) kuota me vlerë nominale 5,000 leke, që përfaqëson 50% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- Ortaku Olgen Cikopana zotëron 1 (një) kuota me vlerë nominale 5,000 leke, që përfaqëson 50% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortakët janë përgjegjës kundrejt paleve të treta për humbjet që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6 Kuotat Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij. Pronesia mbi kuotat do të regjistrohet në regjistrin e ortakëve që do të mbahet në shtet të Shoqërisë nën përgjegjësinë e Administratoreve (“**Regjistri i Ortakëve**”).

Regjistri i Ortakeve do të pasqyrojë informacionin e mëposhtem: (i) identitetin e çdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes që zotërohet nga çdo Ortak; (iii) datën e fitimit të pronësive të secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresën apo selinë e çdo Ortaku; (v) detaje për çdo peng apo barri të vendosur mbi kuotat.


Neni 7 Transferimi i Kuotave

- 7.1. Nëse një Ortak ka për qëllim të transferojë në çdo formë të gjithë apo një pjesë të kuotes së tij një personi të ndryshëm nga Ortaket, secili prej Ortakeve të tjera ka të drejtën e parablerjes mbi të gjithë apo një pjesë të kuotes në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar, në varesi të faktit se sa ortake do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetëm në përputhje me procedurën në vijim.
- 7.2. Nëse një Ortak ka për qëllim të transferojë të gjithë apo një pjesë të kuotes së tij, ai, përpara se të nënshkruajë marrëveshje me persona të ndryshëm nga Ortaket, do të njoftojë me shkrim Administratoren për transferimin e planifikuar, duke përcaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at të cilëve planifikon t'u transferojë kuotën dhe kushtet esenciale që do të aplikohen për transferimin.
- 7.3. Administratori, brenda 10 ditëve duke filluar nga dita kur është njoftuar nga Ortaku për shitjen apo transferimin e planifikuar, do të informojë me shkrim Ortaket e tjera.
- 7.4. Secili prej Ortakeve që ka të drejta parablerjeje, brenda 1 (një) muaji nga njoftimi prej Administratoreve për shitjen apo transferimin e planifikuar, do të njoftojë me shkrim Administratoren nëse ka qëllim të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.
- 7.5. Administratori brenda 10 ditëve nga marrja e këtij njoftimi do të njoftojë me shkrim Ortakun që dëshiron të transferojë kuotat e tij.
- 7.6. Nëse me shumë se një Ortakë ushtrojnë të drejtat e parablerjes së kuotes, ata do të blejnë kuotën në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapitalin themeltar.
- 7.7. Nëse asnjë njoftim nuk është dhënë nga ndonjë Ortak si më sipër, Ortaku që ka për qëllim të transferojë kuotën e tij do të jetë i lire t'ia transferojë kete kuotë personit/ave të përcaktuar prej tij.
- 7.8. Nëse vetëm një Ortak ka dhënë njoftim për qëllimin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ky Ortak do të ketë të drejtë të blejë kuotën objekt transferimi brenda 10 ditëve nga data e mbarimit të afatit 1 (një) mujor të përcaktuar më sipër.
- 7.9. Çdo transferim i kuotave që nuk kryhet në përputhje me parashikimet e këtij neni është i pavlefshëm dhe pa efekte për Shoqerinë.

Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose rritjes së vlerës nominale të atyre ekzistuese ose në çdo formë tjetër të parashikuar nga Ligji. Për çdo zmadhim kapitali të Shoqerisë nëpërmjet emetimit të kuotave të reja, Ortaket do të kenë të drejtën e parablerjes për nënshkrimin e këtyre kuotave të reja të emetuara. Nëse me shumë se 1 (një) Ortak ushtrojnë të drejtat e tyre të parablerjes brenda 20 (njëzet) ditëve, atëherë ata do t'i blejnë këto kuota në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapitalin themeltar. Çdo kuotë e re që nuk është blerë nga Ortaket gjatë këtij procesi, i ofrohet çdo pale të tretë. Kuotat e reja që do të shlyhen si më para në dorë, ashtu edhe në natyrë, do të paguheshin në përputhje me Vendimin përkatës për zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin për Shoqeritë Tregtare.

Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit



Kapitali mund të zvogelohet, me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQËRISË

Neni 10 Asambleja e Përgjithshme e Ortave

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë i Shoqërisë, i cili, veç kompetencave të tjera sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a. përcaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime të Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabel të autorizuar;
- e. miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- j. pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- k. përfaqesimin e shoqërisë në gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- m. miratimin e rregullave të zbatueshme procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çështje të tjera sipas parashikimeve të bera prej këtij Statuti.

Asambleja e Përgjithshme e Ortave mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblese së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me postë të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 10-të pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblese duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortaket për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyrën e marrjes së dokumenteve dhe projekt-vendimeve që duhet të vihen në dispozicion të gjithë Ortave, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortave të paktën 14 (katërmbëdhjetë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortave duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Asambleja e Përgjithshme e Ortave do të thirret nga Administratori dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortave nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratori, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblese së Përgjithshme të Ortave, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime

të vlefshme vetëm, nëse të gjithë ortakët, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me 100% të votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos nëse të gjithë ortakët, janë të pranishëm personalisht, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtese ose kufizojnë / zvogelojnë të drejtat që u janë njohur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut të interesuar / perkates.

Të gjitha vendimet e Asamblese duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

Neni 11

Organi Administrues / Administratorët

Organi Administrues përbehet nga 1 (një) Administrator që emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Kohezigjatja e mandatit të Administratorit është 5 vjetore, me të drejtë rimerimi. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë me afat emerimi nga data 03/04/2024-02/04/2029.

- **Z. Eduart Alicanaj** shtetas shqiptar, atesia Zenel, lindur në Fier më 04/10/1985 dhe banues në Tiranë mbajtës i dokumentit kartë identiteti me Nr.034638331 dhe Nr.Personal I51004056B, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Administratori përfaqëson Shoqërinë sipas parashikimeve të Statutit.

Administratori do të:

- administrojë veprimtarinë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- përfaqësojë Shoqërinë;
- kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabel;
- pergatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- krijojë një sistem njoftimi të pershtatshëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhenave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
- raportoje përpara Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për perfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçante për performancën e Shoqërisë;
- kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;
- thërrasë mbledhjen e Asamblese së Ortakëve sa here që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.

Administratori mund te autorizojë persona te tjere per te vepruar ne emer dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

Neni 12
Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14
Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 15
Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 16
Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 17
Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 18



Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar. Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.


Me qellim shmangien e cdo paqartesisë, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKB) ne autorizojme nepermjet ketij akti Z. Eduart Alicanaj, i cili mund të paraqitet e veprjë me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkesë dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrin Tregtar për kompletimin e regjistrimit.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhet Shqipe dhe Angleze.

ORTAKET THEMELUES

Eduart Alicanaj



Olgen Cikopana

